

VENDIM
Nr. 34, datë 9.2.2018

**MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË “ALESIO–2014” SHPK NË AKTIVITETIN E
PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC “KRYEZI”, ME FUQI TË
INSTALUAR 1990 kw**

Në mbështetje të neneve 16; 37, pika 2, germa “a”, 39, pika 3, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të nenit 4, pika 1, germa “a”; 5, pika 1, germa “a” dhe 13 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, dhe të nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s, nr. 96, datë 17.6.2016, bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 9.2.2018, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut për licencimin e shoqërisë “Alesio–2014” sh.p.k. në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Kryezi”, me fuqi të instaluar 1990 kw,

konstatoi se:

- Me shkresën nr. 818 prot. të ERE-s, datë 26.12.2017, shoqëria “Alesio–2014” sh.p.k., ka paraqitur kërkesën për t’u pajisur me licencë në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Kryezi”.

- Ligji nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, në nenin 38, pika 1, germa “a”, përcakton se: “Afati i vlefshmërisë së licencës, për veprimtaritë e prodhimit, transmetimit dhe shpërndarjes nuk mund të jetë më shumë se 30 vjet.”.

- Jo më vonë se 2 muaj para përfundimit të kohëzgjatjes së vlefshmërisë së licencës së dhënë, personi mund/duhet të kërkojë në ERE rinovimin e licencës.

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 13, datë 10.1.2018, filloi procedurën për licencimin e shoqërisë “Alesio–2014” sh.p.k., në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Kryezi”.

- Aplikimi i shoqërisë “Alesio–2014” sh.p.k., plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE, në “Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, si më poshtë:

Formati i aplikimit (neni 9, pika 1, “a”, “b”, “c”), është plotësuar në mënyrë korrekte.

Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2, “a”, “b”, “c”, “d”, “e”, “f”, “g”) është plotësuar në mënyrë korrekte.

Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3, “a”, “b”, “c”, “d”) është plotësuar në mënyrë korrekte.

Dokumentacioni tekniko-ekonomik (neni 9, pikat 4.1.1, 4.1.2, 4.1.3, 4.1.4, 4.1.5) është plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë “Alesio–2014” sh.p.k., në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Kryezi”, me fuqi të instaluar 1990 kw, për një afat 30-vjeçar.

2. Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut, të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti